



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 426/2 Prot.

Tiranë, më 06.04.2023

V E N D I M

Nr. 51, Datë 06.04.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 45, datë 21.03.2023, e D.G kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore¹” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Kam qenë punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Kam filluar punë pranë kësaj Drejtorie në këtë pozicion me datë 24.12.2007 deri më 26.09.2013. Me datë 26.09.2013 pushohem nga puna pa asnjë shkak ligjor. Çështjen e bëra konflikt gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në përfundim të Gjyqimit me Vendimin Nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë me 06.01.2014, Gjykata Vendosi:

- Pranimin e Kërkesë-Padisë;
- Konstatimin e pavlefshmërisë së Aktit të pushimit nga puna;

¹ Ankuesi është pensionist, lindur në datë 01.10.1951.

² Ankuesi deklaron se është ish i përndjekur politik.

- Rikthimin në punë në pozicionin e punës që mbaja para se të pushohesha nga puna;
- Pagimin e pagës nga momenti i pushimit nga puna deri në momentin e kthimit në punë.

Ky vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (i formës së prerë), me gjithë përpjekjet e vazhdueshme nga ana ime për t'u ekzekutuar sa më parë, gjeti zbatim (pjesërisht) në datën 26.01.2015, datë kur u mor vendimi nga organet kompetente (nga DAP duke bërë riemërimin tim, si nëpunës civil, me dokumentin nr. 3410/10, datë 26.01.2015) për rikthimin në vendin e punës që mbaja para pushimit nga puna, detyrë të cilën e vazhdova deri në momentin që mbusha moshën për të dalë në pension pleqërie në datë 01.10.2016. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, nuk u ekzekutua tërësisht Vendimi i Gjykatës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Për arsye të mos ekzekutimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë të të gjitha detyrimeve që rridhnin nga zbatimi i Vendimin nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pasi ezaurova të gjitha mundësitë për ekzekutimin e këtyre detyrimeve ligjore në mënyrë administrative, në datën 05.09.2016 depozitoj pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Kërkesë-Padinë me Nr. Akti 5776. Pas një kalvari të gjatë zvarritjesh nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në Gjykatën e Apelit dhe anasjelltas, përfundimisht, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas rikthimit të çështjes për rigjykim, sipas Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, shpalli në datën 01.02.2021, Vendimin Nr. 232 (80-2021-238), nëpërmjet të të cilit Vendosi:

- Pranimin e Kërkesë-Padisë të D.G;
- Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ti paguaj paditësit interesat për kryerjen e pagesës së pagës së 16 muajve me vonesë prej 15-18 muaj, në masën totale prej 261.753 lekë, në mbështetje kjo të nenit 120 të Kodit të Punës;
- Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë të derdhi pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Tiranë, kontributin e sigurimeve shoqërore për llogari të ish-punonjësit D.G, si punëdhënës në masën 16.7% të pagës bruto për periudhën 26.09.2013 deri me 20.01.2015, në mbështetje kjo të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore", i ndryshuar, neni 9, në shumën 15.932 lekë për kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi pagën në shumën 9540 lekë.
- Ky vendim është i formës së prerë.

Në datën 03.03.2021 kam depozituar kërkesën për ekzekutimin e Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021 (që ishte njëkohësisht edhe titull ekzekutiv) pranë Zyrës Përmbartimore private "Elite Bailiff's Office", shpk. Zyra e Përmbartimit, ezauroi të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar ekzekutimin e këtij Vendimi Gjykate të formës së prerë, por pa sukses, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, nuk dëshironte të ekzekutonte këtë vendim gjykate, në kundërshtim me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në këtë fushë.

Në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, në datën 21.07.2021, i jam drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me Kërkesën me objekt: - Kërkesë për urdhërimin e kryerjes së veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme për ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. 232, datë 01.02.2021, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre.

Në datën 26.10.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pas shqyrtimit të kërkesës së bërë nga ana ime dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, nxjerr Vendimin nr. 53, datë 26.10.2021, ku ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të posaçme për përfundimin e ekzekutimit të të gjitha pikave të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021 nga ana e debitorit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë brenda një afati 1 muaj.*
- Ky vendim është i formës së prerë dhe me ekzekutim të drejtpërdrejtë.*

Megjithëse kaloi një kohë relativisht e gjatë, jashtë afatit 1 muaj të përcaktuar në vendimin e gjykatës, debitori Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nuk ka ekzekutuar asnjë nga pikat e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021.

Në datën 12.08.2021, i drejtohem Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si institucioni epror i debitorit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me kërkesën: “Për ekzekutimin e Vendimit nr. 232, datë 01.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”. Asnjëherë nuk pati një përgjigje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në datën 03.03.2022 depozitoj pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesën me Objekt: - Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave për ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021, nga ana e debitorit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Në përfundim të Gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 38, datë 07.09.2022, ka Vendosur:

- Pranimin e kërkesës duke konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm 1 vjeçar në kuadër të procedurave për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021, nga ana e debitorit DPM.*
- Paditësit i lind e drejta që konform nenit 399/4 paragrafi i dytë të ushtrojë kërkesë padinë për shpërblimin e dëmit si rezultat i vonesës në ekzekutim.*
- Ky vendim është i formës së prerë.*

Në datën 10.10.2022 kam depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile) Kërkesë-Padinë me objekt: - Kërkesë për një shpërblim të drejtë për dëmin jo pasuror që më është shkaktuar, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme për ekzekutimin e

Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021, nga ana e debitorit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, në masën 250.000 lekë.

Afati maksimal për gjykimin e kësaj Kërkesë-Padije është 3 muaj nga momenti i depozitimit të Kërkesë-Padisë në Gjykatë. Megjithëse kanë kaluar më shumë se 5 muaj nga depozitimi i kësaj Kërkesë-Padie, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ka asnjë lloj lëvizje procedurale për Gjykimin e kësaj çështje.

Kohëzgjatja e gjatë për ekzekutimin tërësisht të një Vendimi Gjykate, duke filluar nga data 13.12.2013 (Vendimi nr. 79, datë 13.12.2013 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) dhe deri më sot (mos ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021), kur nga institucionet e ndryshme shtetërore ekzekutohen në vit me qindra vendime Gjykatash, për çështje nga më të ndryshmet, për mua që jam person me statusin e ish të Përndjekurit Politik nga regjimi komunist, si dhe që kam mbi 5 vjet që kam dalë në pension pleqërie, kuptohet që mos ekzekutimi i Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 232, datë 01.02.2021, brenda një afati të arsyeshëm, më ka shkaktuar një dëm financiar të drejtpërdrejtë, dëm në rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë, duke përbërë njëkohësisht një shkelje të të drejtave të njeriut”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, sipas parashikimeve ligjore.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive

dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

- Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesi, rezulton se, pretendimet për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ai i ka ndjekur sipas procedurës së përcaktuar në ligj, përmes Përmbauesit Gjyqësor.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”*, i ndryshuar, në nenin 2, të tij, ka përcaktuar se: *“1. Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. 2. Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbauesve gjyqësorë”*.

Pika 1, e nenit 5, të këtij Ligji përcakton se: *“Përmbauesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”*.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;

Në nenin 515 dhe 527, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se:

“Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbaues gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbauesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbauesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit”.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies

në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbaruesi gjyqësor.

Me shkresën nr. 559, datë 04.03.2021, Shoqëria Përmbarimore Private “Elite Bailiff’s Office” shpk, ka iniciuar procedurën për ekzekutimin vullnetar të Titullit Ekzekutiv Vendimi nr. 232, datë 01.02.2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Gjatë ndjekjes së procedurës së ekzekutimit vullnetar të vendimit sipërcituar, në kushtet kur ai nuk ka ndodhur, pas kalimit të afatit për ekzekutim vullnetar, Përmbaruesi Gjyqësor ka filluar procedurën për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit.

Evidentohet se veprimet procedurale të Përmbaruesit Gjyqësor për ekzekutimin e këtij vendimi për llogari të ankuesit kanë vijuar dhe aktualisht, ky vendim mbetet i pa ekzekutuar, edhe pas Vendimit nr. 38, datë 07.09.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën është konstatuar shkelja e afatit të arsyeshëm 1 vjeçar, për zbatimin e vendimit nr. 232, datë 01.02.2021.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vlerëson se është shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor që ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëseështë e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri vëren se, nisur nga kërkimet e subjekti ankues, të cilat i referohen pagimit të interesit për kryerjen e pagesës së pagës së 16 muajve vonesë dhe derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas Vendimit përkatës të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; ankuesi, si subjekt i interesuar, mund t’i drejtohet drejtpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 131, shkronja f) e tij, ka parashikuar se:

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

.....f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Pika 1, shkronja i) e pika 2, e nenit 134, të Kushtetutës, përcaktojnë shprehimisht se:

“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

.....i) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”.

Neni 44 i Kushtetutës përcakton se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.*

Neni 142, pika 3 e Kushtetutës përcakton se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.*

Bazuar në sa më lart, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, individët e prekur drejtpërdrejtë, mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti ankues, i ndodhur në kushtet e mësipërme, mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me pretendimin e tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga viti 2021 e deri aktualisht (*Referuar Vendimit nr. 232, datë 01.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga D.G, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA